

VENDIM
Nr. 588, datë 22.7.2026

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN
PENALE, NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Marrjen e masave për hartimin, konsolidimin dhe finalizimin e projektit përfundimtar të Kodit Penal të ri, të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, si dhe të akteve të tjera të legjislacionit penal, që preken nga këto ndryshime, në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe reformimit të politikës penale në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministri i Drejtësisë organizon e ndjek procesin e hartimit të projektakteve dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Për realizimin e procesit sipas këtij vendimi, pranë Ministrisë së Drejtësisë funksionojnë grupe pune *ad hoc*, të krijuara me urdhër të ministrit të Drejtësisë në ushtrim të kompetencave të tij, për hartimin e projektit përfundimtar të Kodit Penal të ri, të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe të akteve të tjera të lidhura, në përputhje me pikën 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

4. Grupet e punës përbëhen nga ekspertë të strukturave të hartimit të akteve në Ministrinë e Drejtësisë dhe institucione të tjera të interesuara, si dhe nga ekspertë të jashtëm, të fushës akademike, vendas e të huaj, me përvojë në hartimin e projektakteve me rëndësi të veçantë. Grupet e punës asistohen nga një sekretariat teknik, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me punonjës të Ministrisë së Drejtësisë ose ekspertë të jashtëm, ose punonjës nga strukturat përgjegjëse për kodifikimin.

5. Ekspertët e jashtëm në grupet e punës dhe anëtarët e sekretariatit teknik shpërblehen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlera totale për secilin ekspert të jashtëm është jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë për një akt, vlerë e cila përballohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2026. Numri i ekspertëve të jashtëm dhe masa konkrete e shpërblimit përcaktohet nga ministri i Drejtësisë, bazuar në kontributin real, të dokumentuar, sipas sugjerimit të drejtuesve të grupit të punës ose në dokumentin e dorëzimit të produktit për secilin akt.

6. Projektaktet dhe dokumentet shoqëruese të hartuara në kuadër të këtij vendimi paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave nga ministri i Drejtësisë, në përputhje me procedurat e paraqitjes, shqyrtimit dhe vendimmarrjes, të parashikuara në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

7. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2026, për Ministrinë e Drejtësisë, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit 01110, “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

8. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

